

URDHËR
Nr. 86, datë 7.5.2025

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 499, datë 29.8.2018, “Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”; të pikës 1, shkronja “a”, të udhëzimit të përbashkët nr. 132, datë 9.9.2023, “Për ngritjen e Autoritetit Përgjegjës për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave drejtorit të Drejtorisë për Politikën e Migracionit, Azilit dhe Antitrafikut, znj. Alma Bime, në cilësinë e Kryetarit të Autoritetit Përgjegjës, për nënshkrimin e praktikave të mëposhtme:

a) shkresave drejtuar institucioneve përgjegjëse dhe partnerëve që kanë detyrime dhe përgjegjësi në proceset dhe çështjet e identifikimit, referimit, mbrojtjes, rikthimit dhe riintegrimin të viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit;

b) të kthimit të përgjigjeve drejtuar Autoritetit Përgjegjës.

2. Delegimin e vulës drejtorit të Drejtorisë për Politikën e Migracionit, Azilit dhe Antitrafikut për praktikën e përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhri.

3. Kompetencat, sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij urdhri, do të ushtrohen nga data 25.4.2025 deri në shfuqizimin e këtij urdhri.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet drejtori i Drejtorisë për Politikën e Migracionit, Azilit dhe Antitrafikut.

5. Me njohjen dhe zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria për Politikën e Migracionit, Azilit dhe Antitrafikut dhe Sektori i Arkiv-Protokollit.

6. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për sigurimin e zbatimit dhe kontrollin e zbatimit të këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSSHËM
Ervin Hoxha